# DËSHMI ARKIVI

**A-475798**

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

VERSIONI 1

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Gjermania, Schweinsteiger nuk i kursen kritikat: Kemi rënë në mediokritet. Klopp? Nuk është magjistar |
| ADRESA | `https://www.gazetatema.net/sport/gjermania-schweinsteiger-nuk-i-kursen-kritikat-kemi-rene-ne-mediokritet-kl-i588910` |
| BURIMI | gazetatema.net |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 28 shtator 2026, 10:01:12 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 28 shtator 2026, 10:50:00 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `56f0edd915549688b6d2c5b42572fb5d666d50499832d0194517067e7785c7c8` |
| TEKSTI | `4f7dfe01ceb1ced77c744428679328265f8727ad1020dc16d67ad65472437b05` |
| PAMJA | `afaab560b8a185023c60c73b57ff608151c9c8bc79252c090131f544feb62c63` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `caaeaf18721d945444206b8f947984d78d50b917f3a710939b528866ee81ce01` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `abea285c66b625fda61d55a4ce47e92e047f4e5aa34cb0aedb7a5ee71b2cb2e0` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/caaeaf18721d945444206b8f947984d78d50b917f3a710939b528866ee81ce01`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

English


# Gjermania, Schweinsteiger nuk i kursen kritikat: Kemi rënë në mediokritet. Klopp? Nuk është magjistar

TemA
28 Shtator 2026, 12:50Sport TEMA



Pas fërshëllimës së arbitrit tifozët në ëëK Arena të Hamburgut, me Gjermaninë që doli e humbur nga sfida me Greqinë, tifozët shprehën pakënaqësinë e tyre përmes fërshëllimave.

Ishte një humbje e dhimbshme kjo për Jurgen Klopp që në ndeshjen e tij të dytë në pankinën e Die Mannschaft nuk e ka gjetur akoma fitoren e tij të parë. Ish trajneri i Liverpool dhe skuadra e tij padyshim që u vunë në qendër të kritikave të shumta. Ai që u tregua më i ashpër ishte një kampion si Bastian Schweinsteiger që më shumë se me teknikun e kap me futbollistët.

*‘Nuk jemi më një skuadër e elitës, kemi rënë në mediokritet. Nuk kemi ushtruar presion mbi kundërshtarët në mënyrë të tillë që të bënim të ndodhte diçka*-tha Schweinsteiger-*Duhen futbollistë që të jenë në gjendje të bëjnë diferencën. Greqia kishte Karetsas,m Tzolis dhe Pavlidis’.*

Më pas Bastian Schweinsteiger doli në mbrojtje të trajnerit Jurgen Klopp.

*‘Klopp nuk është magjistar. Është një punë e vështirë, por edhe futbollistët duhet të pyesin pak veten: kjo është e gjitha?*-tha Schweinsteiger.

Rrethana e madhe lehtësuese në këtë fillim të vështirë të Klopp në pankinën e Gjermanisë qëndron te lloji i punës që po kërkon të bëjë te kombëtarja gjermane. Për këtë mjafton të shohësh listën e të grumbulluarve; plot 44 futbollistë janë thirrur prej tij. Pas dështimit të bujshëm në Botërorin 2026, gjermanët zgjidhën Klopp për të rilindur dhe trajneri ka ndërmarrë këtë rrugë; një bazë të gjerë, testimi i futbollistëve të rinj dhe përpjekja për të transmetuar principet e tij të lojës. Një proces që sigurisht ka nevojë për kohë.

---

## Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

[Italia dhe frika për rënien në Ligën B, sa pikë duhen për ta evituar?]

11:20 Sport

Humbje e hidhur në Vjenë, Kosova mundet 3-1 nga Austria, goli i Zhegrovës nuk mjafton

20:20 Sport / 3 komente

[Përpara ndeshjes me Turqinë: Nuk kemi presion, shoh shumë shqetësim. Edhe para Evropianit që fituam nuk kishte besim]

19:50 Sport / 2 komente

[Not, çiklizëm dhe vrap/ U mbajt edicioni i 6-të i 'Tiranathlon' - Në garë morën pjesë 116 sportistë nga bota]

18:50 Sport

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.